

KONFERENCË PËR ADERIM NË BASHKIMIN EVROPIAN

- MAQEDONIA E VERIUT -

MBLEDHJE MINISTRORE - KONFERENCË NDËRQEVERITARE

PËR PËRMBYLLJEN E FILLIMIT TË NEGOCIATAVE PËR ANËTARËSIM

TË MAQEDONISË SË VERIUT NË BASHKIMIN EVROPIAN

QËNDRIMI I PËRGJITHSHËM I BE-SË

DEKLARATA HYRËSE E BE-SË PËR FILLIMIN E NEGOCIATAVE PËR ANËTARËSIM

1. Pas Konferencës së parë ndërqeveritare politike, të mbajtur më [data] dhe në emër të Bashkimit Evropian, kam kënaqësinë që sot t'u shpreh mirëseardhje përfaqësuesve të nderuar të Maqedonisë së Veriut, për përfundimin e fazës së parë të **hapjes së negociatave për anëtarësim** të vendit tuaj me Bashkimin Evropian.
2. Në përputhje me konkluzionet e Këshillit nga data 25 mars 2020, dhe të miratuara nga anëtarët e Këshillit Evropian më 26 mars 2020, Këshilli [aprovoi në qershor 2022] një **Kornizë Negociuese** të përgjithshme, duke marrë parasysh konkluzionet e lartpërmendura, si dhe konkluzionet e tjera përkatëse të Këshillit, konsensusin e ripërtërirë për zgjerim dhe praktikën e vendosur.

Korniza e Negociatave, të cilën po ua prezantojmë sot, merr parasysh përvojën e zgjerimeve të kaluara dhe negociatave të anëtarësimit që janë në vijim e sipër, si dhe evoluimin e të drejtës së BE-së (*acquis*) dhe në mënyrë përkatëse i pasqyron meritat dhe karakteristikat specifike të Maqedonisë së Veriut. Negociatat kanë për qëllim që Maqedonia e Veriut ta miratojë në mënyrë integrale të drejtën e BE-së (*acquis*) dhe të sigurojë zbatimin dhe aplikimin e plotë të saj. Ajo e përfshin metodologjinë e përmirësuar për zgjerim, e cila **siguron një fokus edhe më të fuqishëm të reformave themelore** në negociatat e anëtarësimit. Prandaj, Maqedonia e Veriut do të duhet t'i pranojë dhe zbatojë plotësisht reformat në fushat themelore të sundimit të ligjit, në veçanti reformën e gjyqësorit dhe luftën kundër

korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtat themelore, forcimin e institucioneve demokratike dhe reformën e administratës publike, si dhe kriteret ekonomike. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes dhe trajtimit jodiskriminues të qytetarëve që u përkasin pakicave ose komuniteteve. Për të siguruar pakthyeshmëri të progresit në këto fusha dhe zbatim të plotë dhe efektiv të tij, Komisioni do të vazhdojë të monitorojë nga afër progresin dhe për këtë do t'i raportojë rregullisht Këshillit.

Duke e pasur parasysh rëndësinë kyçe të reformave themelore gjatë gjithë procesit, **progresi në klasterin e vlerave fundamentale do t'a përcaktojë ritmin e përgjithshëm të negociatave.** Kjo do të mundësojë kohë të mjaftueshme për krijimin e legjislacionit të nevojshëm, të institucioneve dhe evidencave solide për zbatim, përpara mbylljes së negociatave. Raportet e skringut, që do të përgatiten nga Komisioni, do të ofrojnë kahjet e duhura, duke përfshirë edhe detyrat që duhet të adresohen në udhërrëfyesit, të cilat duhet të miratohen nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut.

3. E drejta e BE-së (*acquis*) ndër të tjera përfshin edhe **objektivat dhe parimet mbi të cilat është themeluar Unioni**, siç theksohet në Traktatin e Bashkimit Evropian. Si një shtet anëtar i ardhshëm, ne presim që t'u përmbaheni vlerave të renditura në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian, përkatësisht respektimit të dinjitetin njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe të drejtat e personave që u përkasin pakicave. Për më tepër, anëtarësimi në BE nënkupton zbatimin në kohë dhe efektiv të të gjithë korpusit të së drejtës së BE-së, ose *acquis* së BE-së, ashtu siç qëndron gjatë kohës së anëtarësimit. Sipas metodologjisë së përmirësuar për zgjerim, zhvillimi i kapaciteteve të mjaftueshme administrative dhe gjyqësore, si pjesë e klasterit të vlerave fundamentale, është kyç në përmbushjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi. Lidhur me përkthimet e të drejtës së BE-së (*acquis*) në maqedonisht, BE-ja vuri në dukje deklaratat përkatëse të njëanshme të Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut për gjuhën maqedonase.

4. **Bashkëpunimi rajonal dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë** mbeten elemente thelbësore të procesit të zgjerimit. Maqedonia e Veriut duhet të vazhdojë të angazhohet në mënyrë konstruktive në bashkëpunimin inkluziv rajonal dhe t'i forcojë marrëdhëniet me vendet fqinje. Sot, ne kujtojmë rëndësinë e arritjes së rezultateve të dukshme dhe zbatimit të marrëveshjeve bilaterale me vullnet të mirë, përfshirë edhe Marrëveshjen e Prespës me Greqinë dhe Marrëveshjen për Marrëdhënie të Mira Fqinjësore me Bullgarinë.
5. Në periudhën deri në anëtarësim, nga Maqedonia e Veriut do të kërkohet që në mënyrë graduale **t'i harmonizojë** politikat e saja ndaj vendeve të treta dhe qëndrimet e saja brenda organizatave ndërkombëtare me politikat dhe qëndrimet e miratuara nga Unioni dhe vendet anëtare të tij.
6. Të kujtojmë gjithashtu se paralelisht me negociatat për anëtarësim, Unioni dhe Maqedonia e Veriut do të vazhdojnë **dialogun me shoqërinë civile dhe bashkëpunimin në fushën e kulturës**, me qëllim të afrimit të njerëzve dhe sigurimit të mbështetjes së qytetarëve për procesin e anëtarësimit. Ne presim që Maqedonia e Veriut t'i komunikojë me precizitet dhe në mënyrë strategjike ndaj publikut të saj, përfitimet dhe detyrimet e procesit të anëtarësimit, duke përfshirë edhe ballafaqimin me dezinformata, në përputhje me përcaktimin e saj strategjike proevropian.
7. U mbetet shteteve anëtare të vendosin se a janë kushtet e përshtatshme për përfundimin e negociatave, duke pasur parasysh zhvillimet në të drejtën e BE-së (*acquis*) nga hapja e negociatave dhe gatishmëria e Maqedonisë së Veriut për anëtarësim.
8. Negociatat e anëtarësimit, hapjen e të cilave po e rrumbullakojmë sot, do të jenë rigorozet dhe do të kërkojnë shumë përkushtim. Me vendosmëri dhe përkushtim, jemi të bindur në kapacitetin tuaj se do t'i sillni negociatat në përfundim të suksesshëm. Ne do t'ju mbështesim në përpjekjet tuaja dhe presim me padurim t'ju dëshirojmë mirëseardhje si një anëtar i plotfuqishëm i Bashkimit Evropian.

KORNIZA NEGOCIUESE

Parimet me të cilat rregullohen negociatat

1. Negociatat e anëtarësimit do të **bazohen në nenin 49 të Traktatit** për Bashkimin Evropian (TBE) dhe në mënyrë përkatëse **do të marrin parasysh të gjitha konkluzionet relevante të Këshillit Evropian**, si dhe Deklaratën e Përbashkët të Anëtarëve të Këshillit Evropian të marsit të vitit 2020, me çka miratohet Metodologjia e përmirësuar për zgjerim¹, konsensusi i ripërtërirë për zgjerim i dakorduar nga Këshilli Evropian në dhjetor të vitit 2006 dhe konkluzionet e Këshillit Evropian të vitit 1993 të Kopenhagës.
Metodologjia e përmirësuar e zgjerimit ka për qëllim ta ringjallë procesin e anëtarësimit duke e bërë atë më të parashikueshëm, më kredibil, më dinamik dhe subjekt i drejtimit më të fuqishëm politik, bazuar në kritere objektive dhe kushte rigorozë pozitive dhe negative, si dhe reverzibilitet.
2. Negociatat do të **bazohen në meritat e vetë Maqedonisë së Veriut** dhe dinamika do të varet nga **progresi i Maqedonisë së Veriut në përmbushjen e kërkesave për anëtarësim**. Komisioni ose, sipas rastit, Presidenca, rregullisht do ta informojë Këshillin lidhur me këtë, që të mund Këshilli vazhdimisht ta shqyrtojë situatën. Nga ana e tij, Unioni, në kohë të duhur do të vendosë nëse janë përmbushur kushtet për përfundimin e negociatave; kjo do të bëhet në bazë të një raporti nga Komisioni me të cilin do të konfirmohet që Maqedonia e Veriut i përmbush kërkesat e dhëna në pikën 5. Qëllimi i përbashkët i negociatave është anëtarësimi. Nga natyra e tyre, negociatat janë një proces i hapur, rezultati i të cilave nuk mund të garantohet paraprakisht.
Në fushën e Politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë të BE-së (**PPJS**), Përfaqësuesi i Lartë i Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurisë është përgjegjës, në bashkëpunim të ngushtë me shtetet anëtare dhe Komisionin aty ku është e përshtatshme, për shqyrtim, dhënie të propozimeve në negociata dhe raportim të rregullt në Këshill.
3. Zgjerimi duhet të forcojë procesin e integritetit të vazhdueshëm në të cilin janë të angazhuar Unioni dhe vendet e tij anëtare. Duhet bërë çdo përpjekje për të mbrojtur kohezionin dhe efektivitetin e Unionit. Në përputhje me konkluzionet e Këshillit Evropian në dhjetor të vitit 2006, duke theksuar rëndësinë që BE-ja mund të ruajë dhe thellojë zhvillimin e vet, **ritmi i zgjerimit duhet ta marrë parasysh kapacitetin e Unionit për të pranuar anëtarë të**

¹ [*"Enhancing the accession process - A credible EU perspective for the Western Balkans"*](#) (COM(2020) 57 final)

rinj, gjë që është veçanërisht e rëndësishme për interesin e përgjithshëm si të Unionit ashtu edhe të Maqedonisë së Veriut.

4. Negociatat hapen mbi bazën se Maqedonia e Veriut respekton dhe **angazhohet për promovimin e vlerave mbi të cilat është themeluar Unioni**, të përmendura në nenin 2 të Traktatit të Bashkimit Evropian, përkatësisht respektimin e dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave të cilët u përkasin pakicave.

Negociatat hapen gjithashtu edhe mbi bazën se Maqedonia e Veriut **ka arritur një shkallë të lartë të harmonizimit me kriteret e anëtarësimit**, veçanërisht kriteret politike të përcaktuara nga Këshilli Evropian i Kopenhagës në vitin 1993 dhe nga Procesi i Stabilizim-Asociimit kushtimishit i vendosur nga Këshilli në vitin 1997. Unioni **pret që Maqedonia e Veriut të punojë drejt respektimit të plotë të këtyre kritereve dhe kushteve, të tregojë përkushtim të palëkundur politik dhe të sigurojë zbatimin e plotë të reformave dhe legjislacionit kyç**, respektivisht në fushat themelore të sundimit të ligjit, e posaçërisht reformat në gjyqësor dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të drejtat themelore, përf forcimin e institucioneve demokratike dhe reformën e administratës publike, si dhe kriteret ekonomike.

5. Avancimi i negociatave do të drejtohet nga progresi i Maqedonisë së Veriut në përgatitjen për anëtarësim dhe në nxitjen e konvergjencës ekonomike dhe sociale. Ky progres do të matet në veçanti me kërkesat e mëposhtme:

– **Kriteret e Kopenhagës** në të cilat përcaktohen kërkesat e mëposhtme për anëtarësim:

- stabiliteti i institucioneve që garantojnë demokracinë, sundimin e ligjit, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave;
- ekzistenca e një ekonomie funksionale tregu dhe kapacitet për t'u ballafaquar me presionin konkurrues dhe me forcat e tregut në Union;
- aftësia për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, duke përfshirë edhe respektimin e qëllimeve të unionit politik, ekonomik dhe monetar dhe kapacitetit administrativ për zbatim dhe implementim efikas të së drejtës së BE-së (*acquis*).

- **Procesi i Stabilizim-Asociimit**, i cili mbetet korniza e përbashkët për marrëdhëniet me Ballkanin Perëndimor deri në anëtarësimin e tyre.
- Përbushja e detyrimeve të Maqedonisë së Veriut nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, si dhe progresi i Maqedonisë së Veriut në zgjidhjen e fushave kyçe të identifikuara në raportet e Komisionit dhe konkluzionet relevante të Këshillit.

– Duke e pasur parasysh atë që u tha më lartë, përkushtimi i Maqedonisë së Veriut **për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim më të ngushtë rajonal, duke përfshirë edhe arritjen e rezultateve të dukshme dhe zbatimin e marrëveshjeve bilaterale me vullnet të mirë**, duke përfshirë edhe Marrëveshjen e Prespës me Greqinë dhe Marrëveshjen për Marrëdhënie të Mira Fqinjësore me Bullgarinë të vitit 2017, si dhe rishqyrtimet vjetore dhe masat për zbatimin efektiv të saj sipas nenit 12, në përputhje me Agjendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor të miratuar në qershor të vitit 2003, Deklarata e Sofjes në Maj të vitit 2018, Deklarata e Zagrebit në maj të vitit 2020 dhe Deklarata e Bërdos së tetorit të vitit 2021, konkluzionet e Këshillit për procesin e zgjerimit dhe stabilizimit-asociimit nga marsi 2020 dhe dhjetor 2021 dhe konkluzione të tjera përkatëse të Këshillit.

6. Në periudhën deri në anëtarësim, Maqedonisë së Veriut do t'i kërkohet **që në mënyrë graduale t'i harmonizojë politikat e saja ndaj vendeve të treta dhe qëndrimet e saja brenda organizatave ndërkombëtare** me politikat dhe qëndrimet e miratuara nga Unioni dhe vendet anëtare të tij. Harmonizimi i PPJS-së do të ndiqet rregullisht gjatë procesit të negociatave dhe do të nxitet përmes dialogut të rregullt për PPJS-së.

7. Esenca e negociatave do të zhvillohet në një **Konferencë Ndërqeveritare** me pjesëmarrjen e të gjitha vendeve anëtare nga njëra anë dhe Maqedonisë së Veriut nga ana tjetër. Konferenca ndërqeveritare do të zhvillohet të paktën një herë në vit, pas miratimit të konkluzioneve të Këshillit, duke marrë parasysh pakon vjetore të zgjerimit të Komisionit, çdoherë kur është relevante. Konferenca ndërqeveritare do të sigurojë drejtimin politik dhe një forum për dialog politik mbi procesin e reformës. Gjithashtu **do të bëjë një vlerësim të plotë të procesit të përgjithshëm të anëtarësimit, dhe do të përcaktojë indikacion për vitin e ardhshëm se cilat klasterë/kapituj potencialisht mund të hapen ose mbyllen** dhe masat të mundshme korrigjuese, bazuar në shkallën e zbatimit të reformave. Të gjitha palët do të sigurojnë përfaqësim në konferencën ndërqeveritare në nivelin e duhur. Procedura dhe organizimi i negociatave janë të përcaktuara në Aneksin I.

Komisioni në mënyrë sistematike do t'i konsultojë vendet anëtare gjatë procesit të anëtarësimit. Vendet anëtare mund të kontribuojnë përmes monitorimit në terren nëpërmjet ekspertëve të tyre, me kontribut të drejtpërdrejtë në pakon vjetore për zgjerim dhe ekspertizë sektoriale.

8. Me qëllim që të vendoset **dinamikë** në procesin e negociatave dhe për të nxitur përpjekje të përbashkëta jashtë kapitujve individual, **kapitujt e negociatave do të organizohen në klasterë**

tematike. Këto klasterë bashkojnë kapitujt/fushat sipas temave më të gjera (shih Aneks II) dhe do të lejojnë një **fokus më të fuqishëm të sektorëve thelbësorë.**

9. **Metodologjia e përmirësuar e zgjerimit** parashikon një **fokus edhe më të fuqishëm në reformat në fushat fundamentale të procesit të anëtarësimit** siç theksohet në paragrafin 4, të cilat Maqedonia e Veriut duhet plotësisht t'i pranojë dhe zbatojë. Maqedonia e Veriut medoemos duhet të sigurojë që institucionet e saja, kapacitetet menaxhuese dhe sistemet administrative dhe gjyqësore, janë mjaftueshëm të përforcuara me qëllim të zbatimit efektiv të së drejtës së BE-së (acquis).
10. Duke pasur parasysh rëndësinë kyçe gjatë procesit të reformave themelore, **negociatat për klasterin e vlerave fundamentale do të hapen të parat dhe do të mbyllen të fundit.** Kjo do të mundësojë kohë të mjaftueshme për krijimin e legjislacionit të nevojshëm, institucioneve dhe evidencës solide të zbatimit përpara se të mbyllen negociatat. **Progresi në klasterin e vlerave fundamentale do ta përcaktojë dinamikën e përgjithshme të negociatave** dhe do të merret parasysh gjatë vendimin për hapjen ose mbylljen e klasterëve ose kapitujve të rinj.
11. Nëse Maqedonia e Veriut arrin progres të mjaftueshëm në reformat prioritare të dakorduara në negociata, kjo duhet të çojë në:
 - 1/ **integrim më të afërt** me Bashkimin Evropian, përmes integritit të përsheptuar dhe kyçjes graduale në politikat vetanake të BE-së, tregun e BE-së dhe programet e BE-së, me qëllim që të çlirohet potenciali i një integrimi të tillë, në veçanti duke hequr barrierat teknike për tregti, njëherit duke siguruar kushte për veprim të barabartë; fokus primar duhet tu kushtohet fushave ku vendi kandidat ka treguar kapacitet dhe ekspertizë për eksport në BE, dhe në fushat me interes të ndërsjellë strategjik, ku vendi kandidat siguron prodhim të konsiderueshëm, por duhet të përmbushë normat dhe standardet e BE-së (p.sh. prodhimi i lëndëve të para), si dhe në fushat ku ka një potencial të madh të pashfrytëzuar (p.sh. ekonomia digjitale/e gjelbër).
 - 2/ **rritjen e investimeve dhe financimit**, duke përfshirë intensifikimin e asistencës para-aderuese në përputhje me dispozitat ligjore, rregullat dhe procedurat në fuqi dhe një bashkëpunim më të ngushtë me institucionet relevante financiare ndërkombëtare, me qëllim që të nxiten investimet dhe mbështetja; shfrytëzimi i fondeve të BE-së duhet të krijojë një avantazh të fuqishëm evropian dhe një ekonomi të fuqishme lokale me projektet që zbatohen, nga ana e BE-së dhe bizneseve lokale, aq sa është e mundur dhe në përputhje të plotë me të drejtën e BE-së (acquis), duke përfshirë edhe kornizën përkatëse ligjore të instrumenteve financiare, dhe obligimet ndërkombëtare të BE-së.

12. **Parashikueshmëria** e procesit të anëtarësimit **kërkon masa korigjuese vendimtare dhe proporcionale, në rastet e çfarëdo lloj ngecjeje serioze ose të vazhdueshme, ose regres në zbatimin e reformave** dhe përmbushjen e kërkesave gjatë procesit të anëtarësimit.
- Në rastet konkrete të radhitura më poshtë, që kërkojnë një përgjigje të shpejtë ndaj situatës dhe/ose riverzibilitet të procesit, do të përdoren procedura më të thjeshta, duke përfshirë edhe votimin e me shumicë të kundërt të kualifikuar nga ana e Këshillit.
13. Në rast të **një mosrespektimi serioz dhe të vazhdueshëm të vlerave mbi të cilat është themeluar Unioni nga ana e Maqedonisë së Veriut, Komisioni me iniciativë të vet** ose me kërkesë të arsyetuar të një vendi anëtar, mund të rekomandojë ndërprerje të negociatave dhe të propozojë kushte për një vazhdim eventual.
- Vendimi për ndërprerjen e negociatave do të konsiderohet i miratuar nga Këshilli, përveç nëse, pasi të është dëgjuar ana e Maqedonisë së Veriut, vendos me shumicë të kualifikuar ta refuzojë rekomandimin e Komisionit brenda 90 ditëve. Parlamenti Evropian do të informohet.
- Pasi që Komisioni të vlerësojë se Maqedonia e Veriut i ka përmbushur kushtet për vazhdim eventual, do t'i rekomandojë Këshillit vazhdimin e negociatave të anëtarësimit. Vendimi për këtë do të konsiderohet që është i sjellë nga Këshilli, vetëm nëse me shumicë të kualifikuar nuk vendos ta refuzojë rekomandimin e Komisionit në afat prej 90 ditësh.
14. **Në rast të**
- i) **çdo ngecje serioze ose të zgjatur apo regres në zbatimin e reformave në klasterin vlerat fundamentale, ose**
 - ii) **situatë ku progresi në klasterin vlerat fundamentale, mbetet dukshëm prapa progresit krahasuar me fushat e tjera, dhe kjo sjell deri tek një çekuilibrim të përgjithshëm të negociatave të zgjerimit,**
- dhe pasi të ketë shfrytëzuar të gjitha masat e tjera në dispozicion, **Komisioni me iniciativë të tij** ose me kërkesë të arsyetuar në mënyrë përkatëse të një **vendi anëtar, mund të propozojë tërheqjen e rekomandimeve të saja për hapjen dhe/ose mbylljen e klasterëve dhe kapitujve të tjerë** negociues dhe ta përshtatë punën shoqëruese përgatitore, siç duhet, përderisa nuk zgjidhet ky ngecje, regres ose çekuilibër.
- Vendimi për këtë do të konsiderohet i miratuar nga Këshilli, përveç nëse, pasi ta ketë dëgjuar anën e Maqedonisë së Veriut, vendos me shumicë të kualifikuar ta refuzojë propozimin e Komisionit në afat prej 90 ditësh. Vendet anëtare do të veprojnë në konferencën ndërqeveritare në përputhje me këtë vendim të Këshillit.

Pasi Komisioni të vlerësojë se ngecja, regresi ose çekuilibri janë të zgjidhura, ai do t'i rekomandojë Këshillit t'i hapë dhe/ose mbyllë klasterët dhe kapitujt negociues në fjalë. Vendimi për këtë do të konsiderohet i sjellë nga ana e Këshillit, përveç nëse vendos me shumicë të kualifikuar nuk vendos ta refuzojë rekomandimin e Komisionit në afat prej 90 ditësh.

15. Në rastin e **kapitujve të mbyllur përkohësisht, Komisioni mundet me iniciativë të tij** ose me kërkesë të arsyetuar përkatëse të një **vendi anëtar, të rekomandojë rihapjen e negociatave për kapitullin - dhe klasterin** ku ai bën pjesë, nëse klasteri do të kishte qenë gjithashtu përkohësisht i mbyllur, aty ku Maqedonia e Veriut nuk ka arritur të vazhdojë të përmbushë përcaktimet e rëndësishme ose t'i zbatojë obligimet e saja.

Vendimi për rihapjen e negociatave për kapitujt e mbyllur përkohësisht do të konsiderohet i miratuar nga Këshilli, përveç nëse, pasi ta ketë dëgjuar Maqedoninë e Veriut, nuk vendos me shumicë të kualifikuar ta refuzojë rekomandimin e Komisionit në afat prej 90 ditësh. Vendet anëtare do të veprojnë në konferencën ndërqeveritare në përputhje me këtë vendim të Këshillit.

Pasi Komisioni të vlerësojë se mund të mbyllet kapitulli dhe klasteri i cili është rihapur, do t'i rekomandojë Këshillit mbylljen e këtij kapitulli dhe këtij klasteri. Vendimi për këtë do të konsiderohet i miratuar nga Këshilli, përveç nëse nuk vendos me shumicë të kualifikuar ta refuzojë rekomandimin e Komisionit në afat prej 90 ditësh.

16. Aty ku ka një regres të dukshëm në klaster ose nën një kapitull të caktuar që ende nuk është mbyllur përkohësisht, **Komisioni mundet me iniciativën e tij** ose me kërkesë të arsyetuar në mënyrë përkatëse nga një **vend anëtar, të rekomandojë që hapja e mëparshme e klasterit në fjalë të anulohet.**

Vendimi për të anuluar hapjen e mëparshme të një klasteri do të konsiderohet i miratuar nga Këshilli, përveç nëse, pasi të ketë dëgjuar Maqedoninë e Veriut, nuk vendos me shumicë të kualifikuar të refuzojë rekomandimin e Komisionit në afat prej 90 ditësh. Vendet anëtare do të veprojnë në konferencën ndërqeveritare në përputhje me këtë vendim të Këshillit.

Pasi Komisioni të vlerësojë se klasteri mund të hapet sërish, ai do t'i rekomandojë Këshillit hapjen e këtij klasteri. Vendimi për këtë do të konsiderohet i miratuar nga Këshilli, përveç nëse nuk vendos me shumicë të kualifikuar të refuzojë rekomandimin e Komisionit në afat prej 90 ditësh.

17. Vëllimi dhe intensiteti i **asistencës para-aderuese** gjithashtu mund të përshtatet në linjë rënëse, me përjashtim të mbështetjes për shoqërinë civile, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi.
18. Me qëllim të përforcimit të besimit të publikut në procesin e zgjerimit, **vendimet do të merren në mënyrë sa më të hapur që të jetë e mundur, për të siguruar transparencë më të madhe**. Qëndrimet e përbashkëta të BE-së do të bëhen publike pas miratimit. Nga Maqedonia e Veriut pritet që t'i kryejë përgatitjet e veta në transparencë të plotë me përfshirjen e duhur të palëve të interesuara dhe përmes një dialogu inkluziv dhe të rëndësishëm me qytetarët dhe shoqërinë civile. Konsultimet dhe diskutimet e brendshme do të mbrohen deri në shkallën e nevojshme që është e domosdoshme që të mbrohet procesi i sjelljes së vendimeve, në përputhje me legjislacionin e BE-së për qasje të publikut deri tek dokumentet në të gjitha fushat e aktiviteteve të Unionit.
19. Maqedonia e Veriut **medoemos duhet t'i pranojë rezultatet e çdo negociate tjetër për anëtarësim**, ashtu siç janë në momentin e anëtarësimit të saj. Do të nevojiten angazhime të qarta për të siguruar që asnjë vend anëtar i ardhshëm, nuk është në pozitë që në mënyrë të pajustificuar ta bllokojë aderimin e vendeve të tjera kandidate nga Ballkani Perëndimor, me kusht që ata t'i plotësojnë kriteret për anëtarësim në Union.
20. Paralelisht me negociatat e anëtarësimit, Unioni dhe Maqedonia e Veriut do të vazhdojnë edhe më tej ta avancojnë **dialogun e tyre me shoqërinë civile dhe bashkëpunimin në fushën e kulturës**, me qëllim të afrimit të njerëzve dhe sigurimit të mbështetjes së qytetarëve për procesin e anëtarësimit.
21. Maqedonia e Veriut duhet t'i **komunikojë publikut të saj me saktësi dhe në mënyrë strategjike përfitimet dhe detyrimet e procesit të anëtarësimit**, duke përfshirë ballafaqimin me dezinformatat, në përputhje me përcaktimin e saj strategjik proevropian.

Thelbi e negociatave

22. Anëtarësimi **nënkupton pranim të së drejtave dhe detyrimeve që kanë të bëjnë me Unioni dhe kornizën e saj institucionale, të njohur si “*acquis*” të Unionit.** Maqedonia e Veriut do të duhet ta zbatojë këtë, ashtu siç është në momentin e anëtarësimit. Përveç harmonizimit legjislativ, anëtarësimi veçanërisht nënkupton zbatim në kohë dhe efektiv të së drejtës së BE-së (*acquis*). **E drejta e BE-së (*acquis*) vazhdimisht zhvillohet dhe veçanërisht përfshin:**

- përmbajtjen, parimet, vlerat dhe qëllimet politike të Traktateve mbi të cilat është themeluar Unioni;
- aktet e miratuara nga institucionet në përputhje me marrëveshjet, si dhe praktikatat gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Unionit;
- të gjitha aktet tjetra, ligjërisht detyrues ose jo, të miratuara në kuadër të Unionit, siç janë marrëveshjet ndërinstitucionale, rezolutat, deklaratat, rekomandimet, udhëzimet;
- marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura nga Unioni, nga Unioni së bashku me vendet anëtare, dhe ato të lidhura nga vendet anëtare mes tyre që kanë të bëjnë me aktivitetet e Unionit.

Kjo ka të bëjë me *mutatis mutandis* për Traktatin themelues të Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike (Euratom) dhe për të gjitha aktet e miratuara dhe marrëveshjet e lidhura, në përputhje ose në kuadër të atij traktati, ndaj të cilit do të përmbahet edhe Maqedonia e Veriut.

Maqedonia e Veriut do të duhet në kohë të realizojë përkthime të së drejtës së BE-së (*acquis*) në maqedonisht, përpara anëtarësimit, si dhe do të duhet të trajtojë një numër të konsiderueshëm përkthyesish dhe interpretuesish të nevojshëm për funksionimin e duhur të institucioneve të BE-së pas anëtarësimit të saj.

23. Të drejtat dhe obligimet e dala të cilat Maqedonia e Veriut do të duhet t'i respektojë si shtet anëtar, nënkuptojnë **ndërprerjen e të gjitha marrëveshjeve ekzistuese** dypalëshe ndërmjet Maqedonisë së Veriut dhe Unionit, si dhe të të gjitha marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të lidhura nga Maqedonia e Veriut **të cilat janë jo-kompatibile me detyrimet e anëtarësimit.**

24. Pranimi i të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga e drejta e BE-së (*acquis*) nga ana e Maqedonisë së Veriut, mund të kërkojë përshtatje specifike me të drejtën e BE-së (*acquis*) dhe, **në raste të veçanta, mund të shpjerë deri tek masa kalimtare, të cilat medoemos**

duhet të përcaktohen gjatë negociatave të anëtarësimit. Të gjitha dispozitat e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, që shmangin të drejtën e BE-së (acquis) nuk mund të konsiderohen si precedentë në negociatat e anëtarësimit.

25. Aty ku është e nevojshme, do të dakordohen përshtatje specifike të së drejtës së BE-së (acquis) në bazë të parimeve, kritereve dhe parametrave karakteristike për atë të drejtë të BE-së (acquis) siç i zbatojnë vendet anëtare gjatë miratimit të asaj të drejte të BE-së (acquis) dhe duke i pasur parasysh specifikat e Maqedonisë së Veriut.
26. **Unioni mund të pajtohet me kërkesat e Maqedonisë së Veriut për masa kalimtare, me kusht që ato të jenë të kufizuara në kohë dhe fushëveprim, dhe të shoqëruara nga një plan me faza të përcaktuara qartë për zbatimin e së drejtës së BE-së (acquis).** Për fushat që kanë të bëjnë me zgjerimin e tregut të brendshëm, masat rregullatore duhet të zbatohen shpejt, ndërsa periudhat kalimtare duhet të jenë të shkurtra; aty ku nevojiten përshtatje të domosdoshme që kërkojnë angazhim të konsiderueshëm, duke përfshirë shpenzime të mëdha financiare, mund të parashikohen aranzhmane të përshtatshme kalimtare, si pjesë e një plani buxhetor të detajuar dhe të vazhdueshëm për harmonizim. Në çdo rast, aranzhmanet kalimtare nuk duhet të përfshijnë ndryshime të rregullave ose të politikave të Unionit, të pengojnë funksionimin e tyre të drejtë ose të sjellin çrregullime të konsiderueshme të konkurrencës. Në këtë drejtim, medoemos duhet të mbahet llogari për interesat e Unionit dhe të Maqedonisë së Veriut. Në përputhje me pikën e dytë paragrafi 23 të konkluzioneve të Këshillit Evropian të datës 16/17 dhjetor të vitit 2004, **mund të dakordohen edhe masa kalimtare dhe aranzhmane specifike, në veçanti klauzola mbrojtëse në interes të Unionit.**
27. **Përshtatjet e hollësishme teknike të së drejtës së BE-së (acquis) nuk do të kenë nevojë të korrigojnë gjatë negociatave të anëtarësimit.** Ato do të përgatiten në bashkëpunim me Maqedoninë e Veriut dhe do të miratohen në kohë nga institucionet e Unionit, me qëllim të hyrjes së tyre në fuqi në datën e anëtarësimit.
28. Maqedonia e Veriut **do të marrë pjesë në Unionin ekonomik dhe monetar, që nga anëtarësimi si shtet anëtar me tërheqje,** dhe do të miratojë euron si valutë të saj nacionale, pas vendimit të Këshillit për këtë qëllim, në bazë të një vlerësimi të përmbushjes së kushteve të nevojshme. Pjesa e mbetur e së drejtës së BE-së (acquis) në këtë fushë, zbatohet plotësisht nga anëtarësimi.
29. Për sa i përket fushës së drejtësisë, lirisë dhe sigurisë, anëtarësimi në Bashkimin Evropian nënkupton që Maqedonia e Veriut gjatë anëtarësimit plotësisht e pranon të drejtën e BE-së

(acquis) në këtë fushë, përfshirë edhe të drejtën e Shengenit (acquis). Megjithatë, një pjesë e së drejtës së BE-së (acquis) do të zbatohet vetëm në Maqedoninë e Veriut **pas vendimit të Këshillit për heqjen e kontrolleve të personave në kufijtë e brendshëm, të sjellë në bazë të evaluimit të zbatueshëm të Shengenit për gatishmërinë e Maqedonisë së Veriut**, duke e marrë parasysh raportin e Komisionit i cili konfirmon se Maqedonia e Veriut vazhdon t'i plotësojë obligimet e marra në negociatat e anëtarësimit, e të cilat janë relevante për të drejtën e Shengenit "*acquis*"

Procedurat e negociimit

30. Komisioni do të **ndërmerr një proces formal të skringut të së drejtës** së BE-së "*acquis*", me qëllim që t'i informojë autoritetet e Maqedonisë së Veriut për zhvillimin e së drejtës së BE-së "*acquis*", që ta vlerësojë shkallën e gatishmërisë së Maqedonisë së Veriut për hapjen e negociatave në fusha të caktuara, dhe të merr indikacione preliminare për çështjet që me shumë gjasë do të shfaqen gjatë negociatave. Procesi i skringut, gjithashtu duhet të shërbejë edhe për identifikimin e fushave për integrim të përshpejtuar, që duhet rënë dakord ndërmjet BE-së dhe Maqedonisë së Veriut për monitorimin e organeve të Marrëveshjes së Stabilizim - Asociimit, nëse kjo është e nevojshme. Gjatë skringut, Komisioni, gjithashtu do t'i identifikojë prioritetet kyçe të reformave kundër korrupsionit dhe do ta vlerësojë kapacitetin relevant administrativ.
31. Për qëllimet e skringut dhe negociatave pasuese, **e drejta e BE-së "*acquis*" do të ndahet në më shumë kapituj, ku secili mbulon një fushë të caktuar politike; kapitujt do të grupohen në gjashtë klasterë tematike.** Lista e këtyre kapitujve dhe klasterëve, është dhënë në Aneksin II. Çdo mendim i shprehur si nga Maqedonia e Veriut si nga BE-ja, për një kapitull apo klaster të caktuar të negociatave, në asnjë rast nuk do ta paragjykojë qëndrimin që mund të merret për kapitujt apo klasteret e tjera. Fushat e politikave në të cilat nevojiten përpjekje veçanërisht serioze nga Maqedonia e Veriut për ta harmonizuar legjislacionin me të drejtën e BE-së "*acquis*" dhe për të siguruar zbatimin dhe aplikimin e tij, do të shqyrtohen në një fazë të hershme të negociatave të anëtarësimit. Po ashtu, marrëveshjet e arritura gjatë negociatave për kapitujt ose klasterët e caktuar, madje edhe për ato të pjesërishtmet, nuk mund të konsiderohen si përfundimtare, përderisa nuk arrihet marrëveshje e plotë për të gjitha klasteret.

32. Procesi i skringut do të kryhet nëpër klustere dhe do të **rezultojë me përcaktime të propozuara fillestare, që do t'i identifikojnë reformat kryesore për klusterin si tërësi, sipas nevojës**. Procesi i skringut, gjithashtu do të identifikojë fushat e propozuara për integrim të përshtetshëm, së bashku me kushtet që duhet t'i përmbushë Maqedonia e Veriut për të siguruar harmonizim më të lartë me të drejtën e BE-së "*acquis*" në fushën përkatëse. Bazuar në këtë, Këshilli, duke vepruar njëzëshëm ndaj propozimit të Komisionit, do t'i vendos dhe vlerësojë përcaktimet e fillestare të klusterit si dhe marrëveshjet për fushat për integrim të shpejtë, në përputhje me rregullat dhe procedurat e zbatueshme.
33. Në përputhje me paragrafin 10, duke pasur parasysh rëndësinë thelbësore të reformave në fushat fundamentale, **negociatat për klusterin vlera fundamentale, do të hapen të parat dhe do të mbyllen të fundit, dhe do t'i nënshtrohen procedurës specifike** të theksuar më poshtë, ndërsa klusterët e tjerë mund të hapen si dhe të mbyllen njëkohësisht.
34. **Sa i përket klusterit vlerat fundamenale**, Komisioni, në bazë të raportit të skringut, do të propozojë **udhërrëfyes për kapitujt e sundimit të ligjit, si dhe një udhërrëfyes për reformën e administratës publike**, që do të përgatitet nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut, dhe do të shërbejnë si përcaktime fillestare. Nëse është e nevojshme mund të vendosen përcaktime shtesë për hapjen e kapitujve për prokurime publike dhe kontroll financiar. Këshilli duke vepruar njëzëshëm ndaj propozimit të Komisionit, do t'i vendos dhe vlerësojë këto përcaktime fillestare.
35. Maqedonia e Veriut për këtë qëllim do të ftohet të përgatisë **një udhërrëfyes për kapitujt e sundimit të ligjit (23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe 24 - Drejtësia, liria dhe siguria)**. Ky udhërrëfyes do të miratohet nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut në bazë të udhëzimeve që do të jepen në raportet e skringut nga ana e Komisionit dhe pas një procesi transparent të konsultimeve të rëndësishme me të gjithë vepruesit relevant, përfshirë këtu edhe shoqërinë civile. Udhërrëfyesi duhet t'i përmbajë **reformat prioritare kyçe dhe t'i udhëheq negociatat e anëtarësimit në këto kapituj**, si dhe duhet të përmbajë përgatitjet për përmbushjen e kërkesave për anëtarësim. Maqedonia e Veriut përmes një procesi inkluziv do të miratojë Plan aksionar kushtuar mbrojtjes së të drejtave të pakicave ose komuniteteve, duke përfshirë mes tjerash fushën e mos-diskriminimit, luftën kundër gjuhës së urrejtjes, edukimin, vendosjen e masave efektive, mekanizma për raportimin dhe identifikim të institucioneve përgjegjëse. Zbatimi i këtij udhërrëfyesi dhe Plani të Veprimit do të monitorohet vazhdimisht dhe do të shqyrtohet rregullisht në konferencat ndërqeveritare gjatë gjithë procesit.

36. Maqedonia e Veriut gjithashtu do të ftohet të përgatisë dhe miratojë **një udhërrëfyes për funksionimin e institucioneve demokratike, si dhe një udhërrëfyes për reformën e administratës publike**, për të cilët, Komisioni do të jep udhëzime në raportet e skringut. Këta udhërrëfyes do të zhvillohen përmes një procesi transparent të konsultimeve të rëndësishme me të gjithë aktorët relevant, përfshirë edhe shoqërinë civile. Ata do t'i përcaktojnë angazhimet e përgjithshme të vendit për reforma në fushat përkatëse, me parashikim kohor të qartë dhe hapa konkret. Zbatimi i këtyre udhërrëfyesve do të monitorohet vazhdimisht dhe do të shqyrtohet rregullisht në konferencat ndërqeveritare gjatë gjithë procesit.
37. Pasi që Këshilli në bazë të vlerësimit të Komisionit, do të sigurohet se janë plotësuar përcaktimet fillestare për klasterin **vlerat fundamentale**, Këshilli do të vendosë për hapjen e klasterit të vlerave fundamentale, dhe njëzëshëm do të vendos përcaktime të **përkohshme për kapitujt e sundimit të ligjit** në qëndrimin e BE-së për hapje, bazuar në propozimin e Komisionit. Këto përcaktime të përkohshme konkretisht do të kenë për qëllim, nëse është e nevojshme, miratimin e legjislacionit, vendosjen dhe forcimin e strukturave administrative dhe të një evidencë mesatare të suksesit dhe do të jenë të lidhura ngushtë me aktivitetet dhe përcaktimet e realizimit të udhërrëfyesit dhe planit aksionar. Asnjë kapitull nuk do të mbyllet përkohësisht, përpara se të përmbushen këto përcaktime të përkohshme.
38. Pasi që **Këshilli të sigurohet që këto përcaktime të përkohshme janë të plotësuara**, Këshilli njëzëshëm, do t'i përcaktojë në një qëndrim të përkohshëm **përcaktimet përmbyllëse për klasterin vlera fundamentale si tërësi**, që kërkon evidencë solide të zbatimit të reformave.
39. Pasi Këshilli të sigurohet, në bazë të vlerësimit të Komisionit se përcaktimet mbyllëse janë të plotësuara për klasterin vlerat fundamentale, **Këshilli, njëzëshëm, do të vendosë për mbylljen e përkohshme të klasterit vlerat fundamentale si tërësi**.
40. Për më tepër, zbatimi i përpjekjeve për përmbushjen e kritereve ekonomike do të monitorohet dhe do të shqyrtohet rregullisht në konferencat ndërqeveritare, bazuar në vlerësimin e raporteve të rregullta të Komisionit dhe vlerësimet e Komisionit për Programet e Reformës Ekonomike të Maqedonisë së Veriut. **Lidhja më e fuqishme me procesin e programit të reformës ekonomike**, duhet që t'i ndihmojë Maqedonisë së Veriut t'i përmbushë kriteret ekonomike. Në kuadër të Dialogut ekonomik dhe financiar bashkërisht do të miratohen rekomandime për politika të synuara, të cilat i udhëheqin vendet për plotësimin e përcaktimeve të kritereve ekonomike.

41. **Komisioni do ta informojë dhe njoftojë Këshillin në mënyrë të duhur dhe të rregullt, të paktën dy herë në vit, për gjendjen e klasterit vlerat fundamentale, posaçërisht kapitullin "Gjyqësori dhe të drejtat themelore" dhe "Drejtësi, liri dhe siguri".**
42. Pasi që të jenë hapur negociatat për klasterin vlerat fundamentale dhe pasi që Këshilli të sigurohet në bazë të vlerësimit të Komisionit se, përcaktimet **fillestare për klasterë të tjera apo klasterë të realizuara, Këshilli, njëzëshëm do të vendosë për hapjen e këtij klasteri ose të këtyre klasterëve (që i mbulojnë të gjithë kapitujt e ndërlidhur)**, me përcaktime për mbyllje, që vendosen për secilin kapitull individualisht. Prandaj, negociatat për secilin klaster do të hapen si një tërësi, me çka të gjithë kapitujt brenda klasterit do të hapen njëkohësisht. Aty ku do të realizohen reforma të rëndësishme para hapjes, afati kohor mes hapjes së klasterit dhe mbylljes së kapitujve individual, duhet të kufizohet, mundësisht në një vit, varësisht nga progresi i reformave, me fokus në masat e tjera të nevojshme për të siguruar harmonizimin e plotë dhe me kusht që të jenë përmbushur standardet e përkohshme për kapitujt e sundimit të ligjit.
43. Duke u ndërlidhur me informacionet e marra nga Komisioni gjatë skringut, si dhe nga raportet e rregullta të Komisioni, konkluzionet relevante të Këshillit dhe indikatorët nga palët e treta, aty ku është relevante, Këshilli njëzëshëm me **propozim të Komisionit, do t'i vendosë përcaktimet përfundimtare për mbylljen e përkohshme të secilit kapitull nëse kushtet janë të plotësuara**. Varësisht nga kapitulli, përcaktimet precize do t'i referohen në veçanti harmonizimit të legjislacionit me *acquis* dhe një evidence të kënaqshme në zbatimin e elementeve kyçe të së drejtës së BE-së (*acquis*). Aty ku është relevante, përcaktimet do të përfshijnë edhe plotësim të detyrimeve nga Marrëveshja e Stabilizim -Asociimit, veçanërisht ato që i pasqyrojnë kërkesat në kuadër të së drejtës së BE-së (*acquis*).
- Pasi Këshilli të sigurohet në bazë të vlerësimit nga Komisioni se **janë plotësuar standardet për mbyllje për një kapitull, Këshilli duke vepruar njëzëshëm do të vendosë për mbyllje të përkohshme të kapitullit.**
- Çdo kapitull do të shqyrtohet individualisht sa i përket mbylljes së tij të përkohshme.** Me përjashtim të klasterit vlerat fundamentale, çdo klaster mbyllet me automatizëm përkohësisht, pasi të gjithë kapitujt e tij të jenë mbyllur përkohësisht, pa hapa shtesë për mbylljen e përkohshme të klasterit.
44. **Vendimet e Këshillit për hapjen e klasterëve dhe mbylljen e kapitujve do të marrin parasysh përmirësimin e kapacitetit administrativ në kuadër të klasterëve përkatës dhe kapitujve përbërës të tyre. Për më tepër, politikat kundër korrupsionit do të integrohen**

në të gjithë kapitujt përkatës. Prandaj, një kapitull nuk do të mbyllet përkohësisht përpara se të zbatohen politika të mjaftueshme kundër korrupsionit në atë kapitull konkret.

45. **Kur lindin probleme** gjatë negociatave në kapitujt përkatës ose klasterë, ose kur është e domosdoshme të përshtaten ato me përvojën e fituar me negociatat e vijuese të anëtarësimit, **Këshilli, me pëlqim të njëzëshëm, mundet, me propozime të Komisionit të vendosë për hapje të azhurnuar, përcaktime të përkohshme apo përmbyllëse gjatë procesit, duke përfshirë udhërrëfyes të rinj dhe të ndryshuar**, nëse kjo është e nevojshme. Aty ku negociatat mbulojnë një periudhë të konsiderueshme kohore, ose ku duhet të vendosen elemente të reja siç është e drejta e re e BE-së (acquis) një kapitull i ri mund të shqyrtohet sërish, apo të hapet sërish dhe të azhurnohen përcaktimet ekzistuese.
46. Nga Maqedonia e Veriut do të kërkohet ta theksojë pozicionin e saj lidhur me të drejtën e BE-së (acquis) dhe të parashtrojë raport për progresin e saj në plotësimin e përcaktimeve, duke përfshirë sigurimin e të dhënave statistikore të besueshme dhe të krahasueshme për zbatimin e reformave sipas nevojës. **Transponimi i drejtë dhe nëse është e nevojshme, zbatimi i të drejtës së BE-së (acquis)** nga ana e Maqedonisë së Veriut, duke përfshirë aplikimin efektiv dhe efikas përmes strukturave të përshtatshme administrative dhe gjyqësore, **do të jenë kyçe për dinamikën e negociatave.**
47. Për këtë qëllim, **Komisioni do të monitorojë nga afër progresin e Maqedonisë së Veriut në të gjitha fushat**, duke përdorur të gjitha instrumentet në dispozicion, duke përfshirë shqyrtimet ekspertize në vend ngjarje nga ana e Komisionit dhe nga shtetet anëtare, dialogun sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe indikatorët nga palët e treta, aty ku është relevante, në përputhje me Metodologjinë e përmirësuar. Komisioni do ta informojë rregullisht Këshillin për progresin e Maqedonisë së Veriut, në cilën do fushë gjatë negociatave, e në veçanti gjatë prezantimit të propozim-qëndrimeve të përbashkëta të BE-së. Komisioni do t'i kushtojë vëmendje të veçantë angazhimeve të Maqedonisë së Veriut për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim rajonal, siç përmendet në paragrafin 5 dhe do ta informojë Konferencën ndërqeveritare për zbatimin e tyre.

Këshilli do ta merr parasysh këtë vlerësim kur të vendosë për hapat e mëtejshëm lidhur me negociatat për kapitullin ose klasterin përkatës. Përveç informatave që BE-ja mund t'i kërkojë për negociatat për secilin kapitull dhe klaster, dhe që do të duhet t'i sigurojë Maqedonia e Veriut në konferencën ndërqeveritare, nga **Maqedonia e Veriut do të kërkohet të vazhdojë të sigurojë rregullisht informacione të detajuara në formë të**

shkruar për progresin në harmonizimin dhe zbatimin e të drejtës së BE-së (acquis), madje edhe pas mbylljes së përkohshme të një kapitulli.

PROCEDURA E NEGOCIATAVE DHE ORGANIZIMI I TYRE

1 Kryesimi

Në përputhje me praktikën në negociatat bilaterale mes dy delegacioneve, secili i udhëhequr nga një drejtues, nuk parashtrahet çështja për zgjedhje të kryetarit të konferencës ndërqeveritare.

Punën praktike të përfshirë në kryesimin me takimet, do ta kryejë kreu i delegacionit të Unionit në cilësinë e kryesuesit të delegacionit nikoqir.

2. Qëllimi i takimit

Konferenca Ndërqeveritare do të sigurojë një menaxhim politik dhe forum për dialog politik për procesin e reformës.

Të gjitha palët do të sigurojnë përfaqësim në konferencën ndërqeveritare në nivelin e duhur.

3. Shpeshtësia e takimeve në nivel të ministrave dhe të deputetëve dhe formimi i grupeve të punës

Do të ketë të paktën një takim për periudhë dymbëdhjetë muajshe në nivel të ministrave, duke nënkuptuar se shpeshtësia mund të përshtatet nëse është e nevojshme, duke përfshirë takime shtesë në nivel të zëvendësve.

Negociatat do të mbeten të centralizuara në nivel të ministrave dhe të zëvendësve. Formimi i grupeve të punës nuk duhet të parashikohet, përveç se për përmbushjen e kërkesave objektive të negociatave. Të gjitha grupet e këtilla të punës do të punojnë me autorizim të zëvendësve, në bazë të detyrave eksplicite dhe në përputhje me një orar konkret.

4. Vendi i takimeve

Takimet do të mbahen në Bruksel, por gjatë muajve prill, qershor dhe tetor, çdo takim në nivel të ministrave, do të mbahet në Luksemburg. Në rrethana të jashtëzakonshme, takimet mund të mbahen përmes video-konferencës.

5. Organizimi

(a) Sekretariati

Nën kompetenca të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit Evropian ose përfaqësuesit të tij/saj, shërbime nga sekretariati i konferencës, do të sigurohen nga një ekip i përbërë nga përfaqësues të Sekretariatit të Përgjithshëm të Këshillit dhe zyrtarë të emëruar nga delegacioni i Maqedonisë së Veriut.

(b) Shpenzimet operative të Konferencës

Secila palë do t'i mbulojë shpenzimet e veta të udhëtimit dhe ditore, si dhe pagat e personelit që vihen në dispozicion të Sekretariatit.

Shpenzimet operative të Konferencës (qiradhëniet, mobilet dhe furnizimet e zyrës, telekomunikacioni, interpretimi, përkthimi, personeli ndihmës i rekrutuar për Konferencën, etj.) do të mbulohen me avans nga ana e Këshillit të Bashkimit Evropian.

Këto shpenzime do të vendosen në buxhetin e Këshillit nën një paragraf të veçantë buxhetor.

Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit deri te Konferenca do të parashtojë, siç duhet, raport vjetor për menaxhim financiar me shpenzimet operative. Këto shpenzime do të ndahen ndërmjet pjesëmarrësve në përputhje me procedurat që do të dakordohen bashkërisht.

(c) Përgatitja e dokumenteve të takimit

Sekretariatit të Konferencës do t'i kërkohet t'i hartojë dokumentet e radhitura më poshtë, pa qenë në kundërshtim me dokumentet e tjera të veçanta, dhe duke pas mirëkuptim se nëse është e nevojshme, ato mund të ndryshohen, varësisht nga përvoja:

- Takimet e ministrave:

Nëse është e nevojshme propozim/rezimeja e konkluzioneve pas çdo takimi, do të finalizohet nga të deleguarit dhe do të dorëzohet për miratim formal deri në mbledhjen e ardhshme të ministrave.

- Takime në nivel të zëvendësve:

- Propozim-rezimeja e konkluzioneve pas çdo mbledhjeje duhet të dorëzohet deri në takimin e radhës të zëvendësve, për miratim formal.

- Propozim-raporte për parashtrim në takimet ministrore, nëse është nevojshme.

- Palët negociuese:

Propozim-raporte për zëvendësit.

Klastere të kapitujve/temave negociuese

(Vërejtje: Kjo listë në asnjë mënyrë nuk ndikon në vendimet që duhet të sillen në fazë të caktuar të negociatave për radhitjen sipas të cilës do të vepohet me temat.)

1. Vlerat fundamentale	23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore 24 - Drejtësi, Liri dhe Siguri Kriteret ekonomike Funksionimi i institucioneve demokratike Reforma e administratës publike 5 - Prokurime publike 18 - Statistika 32 - Kontroll financiar
2. Tregu i Brendshëm	- Lëvizje e lirë e mallrave - Lëvizje e lirë e punëtorëve - E drejta e themelimit dhe liria për të ofruar shërbime - Lëvizje e lirë e kapitalit 6 – E drejta e shoqërive tregtare 7 – E drejta e pronësisë intelektuale 8 – Politika e konkurrencës 9 – Shërbimet financiare 28 - Mbrojtja e konsumatorëve dhe mbrojtja shëndetësore
3. Konkurrenca dhe rritja inkluzive	10 - Shoqëri informatike dhe media 16 - Tatime 17 - Politika ekonomike dhe monetare 19 - Politika sociale dhe punësim 20 - Politika industriale dhe e ndërmarrje 25 – Shkenca dhe hulumtim 26 – Arsim dhe kulturë 29 – Unioni doganor
4. Agjenda e gjelbër dhe ndërlidhja e qëndrueshme	14 - Politika e transportit 15 – Energjia 21 - Rrjetet trans-evropiane 27 - Mjedisi jetësor dhe ndryshimet klimatike
5. Resurse, bujqësi dhe kohezion	11 - Bujqësia dhe zhvillimi rural 12 - Siguria e ushqimit, politika veterinare dhe fitosanitare 13 - Peshkataria 22 - Politika rajonale dhe koordinimi i instrumenteve strukturore 33 - Dispozitat financiare dhe buxhetore
6. Marrëdhëniet e jashtme	30 - Marrëdhëniet e jashtme 31 - Politika e jashtme, e sigurisë dhe e mbrojtjes